



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 korrik 2019
Nr. ref.: 1385/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO181/18

Parashtrues

Presidenti i Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e konfliktit të pretenduar të kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës, në lidhje me vendimet e Qeverisë për bartjen e disa pronave publike dhe shoqërore në shfrytëzim apo pronësi të komunave

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të konfliktit të pretenduar të kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti) dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).
3. Pretendimi për konflikt të kompetencës kushtetuese ndërlidhet me ligjshmërinë e bartjes nga ana e Qeverisë të disa pronave shoqërore në shfrytëzim të komunave, duke qenë se, sipas pretendimit, *“Presidenti [...] si kreu i shtetit duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të qartësuar këtë situatë se prona e paluajtshme bartet në mënyrë të ligjshme nga Qeveria në shfrytëzim të komunave dhe nuk pengon institucionet tjera të mandatuara për këtë çështje”*, në pajtim me nenet 83 dhe 84 të Kushtetutës.
4. Në këtë aspekt, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që në dritë të dispozitave kushtetuese të parapara me paragrafin 4, të nenit 92 dhe paragrafit 4, të nenit 93 të Kushtetutës të përgjigjet në pyetjet vijuese:

“1. a duhet [Qeveria] t'i anulojë të gjitha vendimet për bartjen e pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës, për shfrytëzim, tek komunat, në mungesë të bazës ligjore; dhe

2. a duhet [Qeveria] t'i rishikojë të gjitha vendimet, që kanë të bëjnë me tërheqjen nga procesi i privatizimit të pronave dhe kthimin e tyre në pronësi të komunave dhe të respektoj procedurat sipas legjislacionit në fuqi për këtë çështje.”

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nënparagrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafin 9 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës dhe nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 16 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës, bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës, dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar interpretimin e paragrafit 4 të nenit 92 [Parimet e Përgjithshme], paragrafit 4 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës lidhur me ligjshmërinë e bartjes së disa pronave publike dhe shoqërore nga Qeveria tek komunat, në shfrytëzim apo pronësi të këtyre të fundit.
7. Më 20 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban.

8. Më 21 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi nga një kopje të kërkesës Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj (në tekstin e mëtejme: Kryeministri), në cilësinë e udhëheqësit të Qeverisë, dhe e ftoi që të dorëzojë komentet e Qeverisë lidhur me kërkesën, nëse ka, deri më 7 dhjetor 2018. Brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht më 7 dhjetor 2018, Gjykata pranoi komente dhe dokumente shtesë nga Kryeministri.
10. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit), me kërkesë që e njëjta t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit. Me atë rast, Gjykata e ftoi Kryetarin e Kuvendit dhe deputetët e Kuvendit që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 7 dhjetor 2018. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga Kryetari i Kuvendit apo deputetët.
11. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) dhe e ftoi atë që të dorëzojë komente lidhur me kërkesën, nëse ka, deri më 7 dhjetor 2018. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga AKP-ja.
12. Më 21 nëntor 2018, Qeveria përmes Vendimit [nr. 05/76] pezulloi dhe anuloi disa vendime të Qeverisë për bartjen e pronave nën menaxhimin e AKP-së, komunave të Kosovës.
13. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata publikoi Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KO79/18, ku parashtrues i kërkesës ishte Presidenti. Në atë rast, Presidenti, në bazë të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës, kishte kërkuar nga Gjykata që të interpretojë paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës. Gjykata e kishte shpallur kërkesën të papranueshme dhe kishte konstatuar se neni 84 (9) i Kushtetutës nuk është i pavarur prej nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtrimi i çështjeve kushtetuese në Gjykatë duhet të bëhet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës.
14. Më 27 dhjetor 2018, Gjykata, duke pasur parasysh që kërkesa KO181/18 ishte dorëzuar në Gjykatë, para vendimmarrjes së saj në rastin KO79/18, ku përcaktoi se kërkesat e Presidentit në Gjykatë nuk mund të bazohen vetëm në nenin 84 (9) të Kushtetutës, por janë të ndërlidhura me nenin 113 të saj, kërkoj nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij të dorëzuar në Gjykatë, të arsyetojë pranueshmërinë e kërkesës KO181/18 mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës dhe ta saktësojë atë sipas kriterëve të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës. Parashtruesit të kërkesës po ashtu iu dha mundësia që të paraqesë komente në lidhje me komentet e Kryeministrit të 7 dhjetorit 2018, për sa i takon pranueshmërisë dhe meritave të kësaj kërkeje, nëse ka ndonjë. Gjykata përcaktoi që të gjitha sqarimet dhe komentet e parashtruesit të kërkesës duhet të dorëzohen në Gjykatë jo më vonë se më 15 janar 2019.

15. Më 15 janar 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi komentet dhe arsyetimin e tij përkitazi me çështjen nëse kërkesa nr. KO181/18 bie në sferën e juridiksionit të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës. Me atë rast, parashtruesi i kërkesës deklaroi se: *“Kërkesa bie edhe në kufijtë e nenit 113 të Kushtetutës, për shkak se në bazë të nenit 113.3.(1) përcaktohet se Presidenti është i autorizuar të ngre çështje, që ndërlidhen me konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të (...) Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë.”*
16. Më 22 janar 2019, Gjykata e njoftoi Kryeministrin lidhur me komentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e tij, nëse ka, deri më 7 shkurt 2019. Gjykata nuk pranoi ndonjë koment shtesë nga ana e Kryeministrit.
17. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe AKP-në lidhur me komentet dhe dokumentet e dorëzuara nga Kryeministri si dhe me komentet e pranuar nga parashtruesi i kërkesës. Kryetarit të Kuvendit iu kërkuar që një kopje e dokumenteve të bashkëngjitura t’u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit.
18. Më 13 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 17 dhjetor 2012, Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (në tekstin e mëtejme: Ligji nr. 04/L-144), u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
20. Më 22 gusht 2013, Qeveria miratoi Rregulloren QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja nr. 23/2013).
21. Në mes 6 qershorit dhe 6 nëntorit 2018, Qeveria, duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-144 dhe Rregulloren nr. 23/2013, nxori një numër të caktuar të vendimeve për kthimin e pronave shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, komunave të Kosovës. (Shih në këtë aspekt: Vendimi nr. 05/55, Vendimi nr. 06/55, Vendimi nr. 07/55, Vendimi nr. 08/55, Vendimi nr. 09/55, Vendimi nr. 10/55, Vendimi nr. 04/57, Vendimi nr. 05/57, Vendimi nr. 06/57, Vendimi nr. 07/59, Vendimi nr. 11/60, Vendimi nr. 12/60, Vendimi nr. 17/61, Vendimi nr. 12/62, Vendimi nr. 10/65, Vendimi nr. 11/65, Vendimi nr. 06/66, Vendimi nr. 09/69, Vendimi nr. 10/69, Vendimi nr. 11/71, Vendimi nr. 07/74, Vendimi nr. 08/74 dhe Vendimi nr. 09/74).
22. Në mes 12 qershorit 2018 dhe 13 nëntorit 2018, Qeveria nxori vendime për bartjen në pronësi të komunave [Vendimi nr. 15/75] ose në shfrytëzim të komunave [Vendimi nr. 10/51], të disa pronave që ishin në pronësi shtetërore.
23. Më 21 nëntor 2018, Qeveria përmes Vendimit [nr. 05/76]:
 - (i) pezulloi të gjitha vendimet e Qeverisë për kthimin e pronave të AKP-së komunave të Kosovës;

- (ii) anuloi të gjitha vendimet e Qeverisë për kthimin e pronave shoqërore të AKP-së komunave të Kosovës për të cilat verifikohet se ka kontrata të shitjes, apo në të cilat ka masa të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje të AKP-së;
 - (iii) anuloi Vendimin [nr. 05/57] të 17 korrikut 2018; si dhe
 - (iv) la në fuqi vendimet [nr. 10/51] të 12 qershorit 2018, [nr. 01/53] të 26 qershorit 2018, dhe [nr. 15/75] të 13 nëntorit 2018.
24. Më 3 prill 2019, Ligji nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës u publikua në Gazetën Zyrtare dhe sipas nenit 32 (Hyrja në fuqi) hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Përmes këtij ligji u shfuqizua Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i 17 dhjetorit 2012, i cili ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimeve të lartcekura të Qeverisë.

Kërkesa e parashtruesit

25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata interpretimin e paragrafit 4 të nenit 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafit 4 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës.
26. Përmes kërkesës së tij, parashtruesi kërkoi nga Gjykata që në dritë të dispozitave të lartcekura kushtetuese të përgjigjet në pyetjet vijuese:
- “1. a duhet [Qeveria] t'i anulojë të gjitha vendimet për bartjen e pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës, për shfrytëzim, tek komunat, në mungesë të bazës ligjore; dhe*
- 2. a duhet [Qeveria] t'i rishikojë të gjitha vendimet, që kanë të bëjnë me tërheqjen nga procesi i privatizimit të pronave dhe kthimin e tyre në pronësi të komunave dhe të respektoj procedurat sipas legjislacionit në fuqi për këtë çështje”.*
27. Në lidhje me pyetjet e lartcekura, parashtruesi arsyetoi kërkesën e tij si në vijim:

“Sipas Kushtetutës, Qeveria merr vendime në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet.

Në pajtim me Kushtetutën, llojet e pronës duhet të jenë të rregulluara me Ligj, që do të hynte edhe rregullimi i pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës, nuk e ka Ligjin për Pronën Publike, që do të rregullonte, në mënyrë të detajuar edhe çështjen e bartjes së pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës në shfrytëzim të komunave. Çështja e kthimit të një pjese të pronës së paluajtshme nga komunat, të menaxhuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, është rregulluar me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144 [...], dhe nenin 19 të Rregullores QRK nr. 23/2013 [...].

[...]

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është autoriteti që merr Vendim për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga autoritetet lokale, ose refuzimin e këtyre kërkesave të parashtruara nga autoritetet komunale, duke përcaktuar arsyet për refuzim. Lidhur me kthimin e pronës

shoqërore në emër të disa komunave, kemi pranuar edhe një shkresë (Lënda nr. Prot.: 1221, datë 07.11.2018) nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, lidhur me vendimet e Qeverisë për këtë çështje, ku ka shpreh qëndrimin se duke pasur parasysh paqartësinë juridike dhe jo rregullimin e saktë ligjor në këtë çështje, AKP e ka të pamundur ligjërisht që të zbatoj nenin 12 (4) të Ligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe për këtë e ka njoftuar Qeverinë, Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Komunat dhe institucionet tjera, njëherit përmes kësaj shkrese jemi njoftuar se për disa prona që ka marrë vendim Qeveria për kthimin në emër të komunave, janë shitur dhe për disa prona ka masa të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.”

28. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, parashtuesi argumentoi:

“Kërkesa parashtrohet në pajtim me nenin 84.9 të Kushtetutës, ngase kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, kur ka të paqartë çështje kushtetuese, të cilat i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë dhe me qëllim të realizimit të rolit primar të Presidentit, si përfaqësues i unitetit juridik kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve dhe të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.”

29. Sipas parashtuesit të kërkesës: “Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e Kushtetutës, është përcaktuar me nenin 112.1 të Kushtetutës:

“Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Neni 84. 9, i Kushtetutës shprehimisht i jep Presidentit kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.

Presidenti bart përgjegjësinë e zbatimit të Kushtetutës dhe garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në zbatimin e një përgjegjësie të tillë kushtetuese, Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në raste kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë kur dispozita kushtetuese është e paqartë, dhe kërkohet të merret Vendim që prodhon efekte juridike.

Në këtë kontekst, paqartësia qëndron në marrjen e vendimeve nga Qeveria [...] për kalimin e pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës në shfrytëzim të komunave, duke pasur parasysh se, sipas Kushtetutës, vendimet, Qeveria duhet t'i merr në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet dhe se nuk kemi Ligj përkatës për prona publike.”

30. Parashtruesi i kërkesës, më tej, arsyetoi se “Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës ka jurisdiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Pa dyshim, në këtë rast, këto dy kushte plotësohen dhe rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucione të mandatuara për referim. Në rastin konkret, kërkohet interpretimi i neneve 92 (4) dhe 93 (4) të Kushtetutës, në atë mënyrë që të qartësohen këto dispozita kushtetuese lidhur me atë, se a ka të drejtë Qeveria, që pronat e paluajtshme të Republikës së Kosovës (pronat publike), t’i bartë në shfrytëzim të komunave me vendime, kur e kemi parasysh se nuk kemi Ligj për prona publike.”
31. Parashtruesi i kërkesës në fund theksoi se: “në rrjedhë të asaj që u theksua më lart, pranueshmëria e kësaj kërkesë nga Gjykata Kushtetuese është e vetëkuptueshme.”

Komentet e dorëzuara nga Kryeministri

32. Më 7 dhjetor 2018, Kryeministri ka dorëzuar komentet e tij në Gjykatë, pas njoftimit të kësaj të fundit për regjistrimin e kërkesës. Gjykata vëren se pas dorëzimit të sqarimeve nga parashtruesi i kërkesës më 15 janar 2019 dhe pas njoftimit të dytë të Gjykatës drejtuar Kryeministrit lidhur me sqarimet e dorëzuara të Presidentit për çështjen e “konfliktit të kompetencave kushtetuese” në mes të Presidentit dhe Qeverisë, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment shtesë nga Kryeministri si përgjigje ndaj sqarimeve të dorëzuara nga Presidenti. Si rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të paraqesë vetëm komentet e dorëzuara në përgjigje të njoftimit të parë të Gjykatës.
33. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës Kryeministri sqaron se parashtruesi “kërkesën e tij për interpretim të paragrafit 4 të nenit 92 (Parimet e Përgjithshme) dhe paragrafit 4 të nenit 93 (Kompetencat e Qeverisë) të Kushtetutës, edhe këtë herë si në rastin KO79/18 ka mbështetur referimin në nenin 84 paragrafin 9, si dhe në nenin 112, paragrafi 1, të Kushtetutës. Për këtë rast të veçantë, gjithnjë sipas sqarimit të Gjykatës Kushtetuese, theksohet shprehimisht se ajo nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose me mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës.”
34. Në lidhje me këtë, Kryeministri më tej sqaron se, “[kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3. [...] Andaj, duke marrë parasysh bazën mbi të cilën është parashtruar kërkesa, duke mos mohuar të drejtën e Presidentit të ngrisë çështje para Gjykatës, shihet se kërkesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë për shkak të mungesës së bazës themelore juridiksionale të Gjykatës në lidhje me autorizimet e Presidentit si palë e autorizuar e që rrjedhin kryekëput nga neni 113 i Kushtetutës.”

35. Si përgjigje përkitazi me kontekstin ligjor për vendimet e ekzekutivit, Kryeministri sqaroi se Kushtetuta sipas nenit 93 (4), mes tjerash, parasheh që Qeveria merr vendime për zbatimin e ligjeve, si dhe sipas nenit 93 (2), Qeveria *"mundëson zhvillimin ekonomik të vendit"*. Më tej, ai theksoi se paragrafi 4 i nenit 12 (E drejta e Komunes në kthimin e një pjesë të tokës të menaxhuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit) i Ligjit nr. 04/L-144 i jep kompetencën ekskluzive Qeverisë që në bashkëpunim me AKP-në të ndërmer veprime ligjore për kthimin e parcelave të ish-ndërmarrjeve shoqërore, në pronësi komunale. Kjo e drejtë e kthimit të pronës së menaxhuar nga AKP-ja, rregullohet edhe me Rregulloren nr. 23/2013.
36. Sipas Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenit 15.3, Agjencia merr vendime për privatizim ose likuidim të ndërmarrjeve vetëm pas konsultimit me zyrtarët komunal ku ndodhet ndërmarrja shoqërore. Ai po ashtu sqaroi se Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i jep kompetenca komunave në lidhje me *"zhvillimin lokal ekonomik"*. Ai po ashtu i referohet edhe Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme i cili rregullon procedurën për shpronësim të pronës së paluajtshme.
37. Për sa i përket natyrës së vendimeve të Qeverisë, përgjigja e Kryeministrit mund të përmbledhet si vijon: (i) bazuar në nenin 93 (4) [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, Qeveria ka të drejtë, përveç tjerash, të marrë vendime si kompetencë kushtetuese e pakontestueshme, *ex lege*; (ii) bazuar në nenin 92 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, vendimet e Qeverisë kanë titull ekzekutiv sepse natyra kushtetuese e pushtetit të Qeverisë është ekzekutive; (iii) Kosova ende nuk ka ligj për Qeverinë, por bazuar në nenin 99 [Procedurat] të Kushtetutës, Qeveria ka nxjerrë Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011; (iv) Rregullorja e punës e Qeverisë ka përcaktuar se çështjet që lidhen me punën e Qeverisë që nuk janë rregulluar me atë rregullore, përcaktohen me vendim ose me akt tjetër të Qeverisë; (v) Vendimi i kontestuar i Qeverisë është akt juridik kolektiv i miratuar me votë nga tërë kabineti qeveritar pas konstatimit të kuorumit të nevojshëm; dhe (vi) sikur vendimet e Qeverisë të kontestoheshin pafundësisht, do të cenohej siguria e vendimmarrjes qeveritare.
38. Më tej, Kryeministri sqaron kronologjinë e marrjes së vendimeve të Qeverisë për të cilat parashtruesi i është drejtuar Gjykatës duke sqaruar hapat e ndërmarrja në lidhje me këto vendime dhe ndërveprimin ndër-institucional deri te marrja e vendimit, duke sqaruar procedurën në lidhje me kërkesat e komunave, veprimet e Qeverisë dhe përfshirjen e AKP-së në këtë proces. Kryeministri po ashtu sqaron se në lidhje me vendimet për bartjen e pronës së ndërmarrjeve shoqërore, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejshëm: MAPL) ka proceduar kërkesat në AKP për zhvillimin e procedurave për kthimin e pronave të komunave sipas legjislacionit në fuqi.
39. Sipas përgjigjes së Kryeministrit, bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144, komunat, me qëllim të realizimit të interesit publik, kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e pronave të ish-ndërmarrjeve shoqërore të cilat menaxhohen nga AKP. Gjithashtu, sipas nenit 19 të Rregullores nr. 23/2013, *"[p]as pranimit të Listës së pronës dhe kërkesës së komunës për tërheqje nga procesi i privatizimit dhe kthimit të tyre në pronësi të komunës me qëllim të realizimit"*

të interesit publik lokal, të pronave që menaxhohen nga AKP, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale të njëjtat lista dhe kërkesa i dërgon në Agjencionin Kosovar të Privatizimit.”

40. Ai po ashtu sqaron se Ligji nr. 04/L-34 për AKP-në, AKP merr vendime për privatizim apo likuidim vetëm pasi që të konsultohet me zyrtarët e komunave në të cilat ndodhet ndërmarrja shoqërore.
41. Në fund, Kryeministri sqaron se pas dërgimit të rastit KO181/18 në Gjykatë, Qeveria ka nxjerrë Vendimin [nr. 05/76], për pezullimin e vendimeve të Qeverisë lidhur me vendimet që janë objekt shqyrtimi në Gjykatë, si dhe ka formuar një grup punues në lidhje me këtë.

Sqarimet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

42. Në sqarimet e tij të dorëzuara në Gjykatë, pas kërkesës së Gjykatës të datës 27 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës ripërsëriti se *“kërkesa është parashtruar për interpretimin e neneve 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës, në cilësinë e kreut të shtetit, përfaqësuesit të unitetit të popullit, dhe garantuesit të funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenet 83 dhe 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*.
43. Më tutje, lidhur me bazën juridike për parashtrimin e kërkesës, parashtruesi theksoi se *“Kërkesa bie edhe në kufij të nenit 113 të Kushtetutës, për shkak se në bazë të nenit 113.3.(1), përcaktohet se Presidenti është i autorizuar të ngre çështje, që ndërlidhen me konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, që në rastin konkret ka të bëjë me konfliktin në mes të Presidentit dhe Qeverisë, në atë mënyrë që të qartësohen dispozitat kushtetuese, se prona e paluajtshme e Republikës së Kosovës bartet në shfrytëzim të komunave në pajtim me legjislacionin në fuqi”*.
44. Tutje, parashtruesi përsëriti pretendimet e tij dhe i përfundoi sqarimet e tij për Gjykatën duke theksuar me sa vijon:

“Duke marrë parasysh nenin 84.9 të Kushtetutës, kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, nenin 112.1 të Kushtetutës, ku kjo dispozitë përcakton se Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, nenin 113.3.(1), ku përcaktohet se Presidenti mund të ngre çështje që ndërlidhen me konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës dhe se duke marrë parasysh faktin se kjo kërkesë bie edhe në kufijtë e këtij neni, që në rastin konkret ka të bëjë me konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Qeverisë, përkitazi me bartjen e pronave të paluajtshme të Republikës së Kosovës, ngase Presidenti në pajtim me nenet 4.3, 83 dhe 84 të Kushtetutës, përfaqëson unitetin e popullit, është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së

Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe se kreu i shtetit duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të qartësuar këtë situatë se prona e paluajtshme bartet në mënyrë të ligjshme nga Qeveria në shfrytëzim të komunave dhe nuk pengon institucionet tjera të mandatuara për këtë çështje”.

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

“Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.

Neni 83 [Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;*
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;*
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;*
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;*
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;*
- (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;*
- (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;*
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misionëve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;*
- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;*
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;*
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;*
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;*
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;*

- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
- (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
- (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (24) vendos për formimin e misionëve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
- (30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Neni 92 [Parimet e Përgjithshme]

[...]

4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

[...]

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

[...]

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

[...]"

Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

"Neni 12 (E drejta e Komunës në kthimin e një pjesë të tokës të menaxhuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit)

1. Komunat kanë të drejtë për interes publik, kthimin e pronës së paluajtshme që përfshinë tokat e ish-Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në territorin e Komunës dhe tani administrohen dhe menaxhohen nga AKP-ja.

2. Komunat duhet të hartojnë listën e parcelave të tokave, prona këto të ish-Ndërmarrjeve Shogërore tani të menaxhuara nga AKP-ja, që Komunat kërkojnë t'i rikthejnë për interes publik.

3. Lista e pronave të cilat i hartojnë komunat sipas paragrafit 2. të këtij neni i dërgohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të tërheqjes nga procesi i privatizimit dhe kthimit të tyre në pronësi të komunës me qëllim të realizimit të interesit publik.

4. Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me AKP-në ndërmarrin veprimet ligjore për kthimin e këtyre parcelave në pronësi të komunës.”

Rregullorja QRKNR. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës

“Neni 19 (E drejta e kthimit të pronës të menaxhuar nga AKP)

1. Pas pranimit të Listës së pronës dhe kërkesës së komunës për tërheqje nga procesi i privatizimit dhe kthimit të tyre në pronësi të komunës me qëllim të realizimit të interesit publik lokal, të pronave që menaxhohen nga AKP, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale të njëjtat lista dhe kërkesa i dërgon në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit bazuar në ligjin përkatës për Agjencinë Kosovare të Privatizimit merr vendim për:

2.1 Aprovimin e kërkesave të parashtruara nga autoritetet lokale, ose

2.2 Refuzimin e këtyre kërkesave të parashtruara nga autoritetet komunale, duke përcaktuar arsyet për refuzim.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Në mënyrë që të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Presidenti.

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.

(2) Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

- (1) *konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;*
 - (2) *përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;*
 - (3) *përputhshmëria e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme me Kushtetutën;*
 - (4) *përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;*
 - (5) *nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.*
47. Sipas Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, autoriteti i Presidentit për të referuar çështje kushtetuese duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës dhe se dispozita kushtetuese e përcaktuar me paragrafin 9, të nenit 84 të Kushtetutës ku thuhet se Presidenti mund të “*referojë çështje kushtetuese*” – është e ndërlidhur me nenin 113 të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO79/18, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 72, 74, 77, 78 dhe 82).
 48. Andaj, Gjykata vëren se dispozitat e lartcekura kushtetuese të cituara nga neni 113 i Kushtetutës janë baza e vetme mbi të cilën Presidenti mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese.
 49. Para se të shqyrtojë tutje pranueshmërinë e kërkesës së parashtruesit, Gjykata fillimisht vëren se Qeveria përmes Vendimit [nr.05/76] të datës 21 nëntor 2018, kishte anuluar të gjitha vendimet e Qeverisë për kthimin e pronave shoqërore të AKP-së komunave të Kosovës për të cilat verifikohet se ka kontrata të shitjes, apo në të cilat ka masa të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me AKP-në. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të trajtojë kërkesën parashtruesit në raport me këto vendime duke qenë se të njëjtat tashmë janë të anuluar nga vet Qeveria.
 50. Për t’u kthyer tek rasti konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës fillimisht kërkesën e tij e kishte mbështetur në paragrafin 9 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.
 51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se pas ofrimit të sqarimeve nga ana e Presidentit, ky i fundit deklaroi se kërkesa e tij bie “*edhe në kufijtë*” e nenit 113.3 (1) meqë rasti “*ka të bëjë me konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Qeverisë*”. Pra, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në rastin konkret pretendon se ekziston një konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit dhe Qeverisë.

52. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Presidenti, në cilësinë e parashtruesit ka ngritur rast të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes tij dhe Qeverisë. Sipas pretendimit, rasti konkret *“ka të bëjë me konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Qeverisë, përkitazi me bartjen e pronave të paluajtshme të Republikës së Kosovës”*. Sipas të njëjtit pretendim, parashtruesi i kërkesës në këtë rast, përkatësisht Presidenti si përfaqësues i *“unitetit të popullit”* dhe përfaqësues *“legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës”*, *“duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të qartësuar këtë situatë se prona e paluajtshme bartet në mënyrë të ligjshme nga Qeveria në shfrytëzim të komunave dhe nuk pengon institucionet tjera të mandatuara për këtë çështje.”*
53. Në lidhje me këtë, Presidenti i ka dorëzuar në Gjykatë tri vendimet vijuese të Qeverisë:
1. Vendimin e Qeverisë [nr. 05/55] të 6 korrikut 2018 - për kthimin e pronave shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, komunës së Gjilanit, me qëllim të realizimit të interesit publik, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144;
 2. Vendimin e Qeverisë [nr. 10/51] të 12 qershorit 2018 - për aprovimin e kërkesës së komunës së Prizrenit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të *“ish-Sekretariatit Federativ për Mbrojtje Popullore”* në shfrytëzim të Komunës së Prizrenit; dhe,
 3. Vendimin e Qeverisë [nr. 11/55] të 6 korrikut 2018 - për aprovimin e propozimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me kërkesën e Komunës së Hanit të Elezit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës e cila gjendet në zonën kadastrale Hani i Elezit të evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. 000.16-0,00017-1 dhe 00020-0.
54. Rrjedhimisht çështja e shtruar para Gjykatës është nëse Qeveria, duke nxjerrë vendime për bartjen e disa pronave të ndërmarrjeve shoqërore komunave të Kosovës, duke u dhënë në shfrytëzim komunave disa prona shtetërore dhe duke bartur pronësinë e disa pronave shtetërore tek komunat, është përfshirë në konflikt të kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Qeverisë.
55. Gjykata, në këtë drejtim, rikujton dispozitën kushtetuese në bazë të së cilës mund të ngritet një çështje për konflikt të kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Qeverisë:
- “3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;*
- [...].”*
56. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se rasti i parë për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese ishte rasti KO131/18, ku parashtrues i kërkesës ishte Presidenti i cili pretendonte konflikt të mes të kompetencave të

tij kushtetuese dhe Kuvendit (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO131/18, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 marsit 2019).

57. Në atë rast, Gjykata theksoi kriteret kushtetuese të parapara me Kushtetutë, kriteret ligjore të përcaktuara me Ligj dhe rregullat e Rregullores së punës – si dispozita që duhet vlerësohen, rast pas rasti, në mënyrë që të determinohet se një rast konkret a ka të bëjë me konflikt në mes të kompetencave kushtetuese apo jo (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KO131/18, cituar më lart, paragrafët 92-95).
58. Gjykata rikujton interpretimin e saj se neni 113.3 (1) i Kushtetutës ngërthen në vete tri kushte të nivelit kushtetues, përkatësisht domosdoshmërinë që: (i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuar; (ii) çështja të ngritët për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar; dhe, (iii) të ketë një konflikt (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KO131/18, cituar më lart, paragrafët 92-95).
59. Për sa i takon kushtin (i), Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës e autorizon Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë që të ngrenë rast të konfliktit në mes të kompetencave të tyre kushtetuese. Ky autorizim është i ndërsjellë dhe secili prej këtyre palëve të autorizuar mund të ngrenë çështje të konfliktit të kompetencave për njërën apo palën tjetër, duke mos përjashtuar mundësinë e ngritjes së konfliktit kundrejt dy palëve njëkohësisht. Në rastin konkret, kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që kërkesa është parashtruar nga Presidenti kundrejt Qeverisë, si njëri nga tri palët e mundshme që janë të autorizuar për të ngritur çështje të konfliktit në mes të kompetencave të tyre respektive kushtetuese.
60. Për sa i takon kushtin (ii), Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës përcakton që konflikti mund të ngritët vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar. Ndonëse Kushtetuta e lë të hapur objektin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese, ajo bën një kufizim të rëndësishëm lidhur me atë se konflikti i supozuar i kompetencës kushtetuese duhet të burojë patjetër nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për Presidentin, Kuvendin, respektivisht Qeverinë.
61. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, së pari, thirret në rolin e tij të përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, sipas së cilës: *“Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.”*
62. Së dyti, parashtruesi i kërkesës thirret në rolin e tij të përcaktuar me nenin 83 [Statusi i Presidentit] të Kushtetutës, sipas së cilës: *“Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”*.

63. Dhe së treti, ai thirret në kompetencat e tij kushtetuese të përcaktuara me nenin 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk thekson ndonjë paragraf të veçantë kushtetues të nenit 84 të Kushtetutës, por thirret në të gjithë nenin 84 i cili përcakton kompetencat e Presidentit, e që gjithsej ngërthen 30 paragrafë, përkatësisht, 30 kompetenca të numëruara për Presidentin.
64. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se roli i Presidentit i përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 4 të Kushtetutës dhe 83 të Kushtetutës është i ndërlidhur me ushtrimin e kompetencave të tij të përcaktuara në nenin 84 të Kushtetutës.
65. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se asnjë nga kompetencat e numëruara në nenin 84 të Kushtetutës nuk i jep Presidentit kompetencë që të ndërmerr ndonjë veprim në lidhje me çështjet të cilat i ngrihtë Presidenti para Gjykatës.
66. Për më tepër, Gjykata i referohet paragrafit 6 të nenit 84 të Kushtetutës që përcakton në mënyrë shprehimore se Presidenti *“ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj.”*
67. Gjykata vëren që një kompetencë të tillë, Kushtetuta nuk ia jep Presidentit në raport me vendimet që nxjerrë Qeveria duke u bazuar në ligje apo në lidhje me zbatimin e ligjeve.
68. Sa i përket autorizimit të parashtruesit të kërkesës, respektivisht Presidentit të Republikës së Kosovës për të kontestuar akte të Qeverisë, Gjykata i referohet nenit 113.2 (1) sipas të cilit: *“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës [parashtruesi i kërkesës], Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë [para Gjykatës] rastet në vijim: (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën.”*
69. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Kushtetuta ka paraparë dispozita specifike në bazë të së cilave palët e autorizuar të cituara më lart, përfshirë Presidentin, mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e akteve të Qeverisë të cilat janë të parapara me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës. Për të bërë një gjë të tillë, palët e autorizuar janë të obliguara që në mënyrë specifike t'i referohen dispozitave përkatëse kushtetuese në bazë të të cilave mund të kontestojnë para Gjykatës akte të Qeverisë si dhe po ashtu të arsyetojnë pretendimet e tyre bazuar në dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës, të cilat më tutje konkretizojnë nenin 113.2 (1) të Kushtetutës (shih në këtë aspekt, nenin 29 dhe 30 të Ligjit dhe rregullin 67 të Rregullores së punës). Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë një gjë të tillë por ka kërkuar që kërkesa e tij të shqyrtohet në bazë të nenit 113.3 (1) të Kushtetutës, duke pretenduar se ekziston konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të tij dhe Qeverisë.
70. Megjithatë, në këtë aspekt, Gjykata thekson se kur një palë ngrihtë pretendime për çështje të konfliktit të kompetencave në mes të Presidentit, Kuvendit dhe Qeverisë, sipas nenit 113.3 (1) të Kushtetutës, siç është rasti me kërkesën e

tanishme të dorëzuara nga Presidenti i Republikës së Kosovës si parashtrues i kërkesës, është obligim i këtij të fundit për të argumentuar se çështja të cilën e ngrit para Gjykatës ndërlidhet me kompetencat e tij kushtetuese, dhe më pas, po ashtu të arsyetojë pretendimet e tij për konflikt në mes të kompetencave kushtetuese.

71. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë se çështjet që ngritë në lidhje me kompetencat e Qeverisë për bartjen e pronësisë apo në shfrytëzim të pronave të ndërmarrjeve shoqërore, respektivisht, shtetërore, ndërlidhen me kompetencat kushtetuese të Presidentit. Kjo dërgon në konkluzionin që kushti i dytë kushtetues i paraparë me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës që përcakton se konflikti mund të ngritët vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar – nuk është plotësuar në rastin konkret.
72. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh që Gjykata sapo konstatoi se çështjet që ngritë parashtruesi i kërkesës nuk ndërlidhen me kompetencat e tij të përcaktuara me Kushtetutë, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të vlerësojë kushtin (iii) të pranueshmërisë së kërkesës, respektivisht, nëse ekziston *“konflikti”* në mes të kompetencave të Presidentit dhe Qeverisë.
73. Prandaj, si përfundim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ndonëse është palë e autorizuar që të ngritë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të tij dhe Qeverisë, ai nuk e ka dëshmuar që çështja e ngritur ndërlidhet me kompetencat e tij të parapara me Kushtetutë.
74. Pra, parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar saktë se si nxjerrja e vendimeve të Qeverisë për bartjen e pronave të ndërmarrjeve shoqërore apo shtetërore tek komunat *“ka të bëjë me konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes Presidentit dhe Kuvendit”*.
75. Po ashtu, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka shtruar kërkesën e tij në formë të pyetjes për të qartësuar dispozitat kushtetuese, se prona e paluajtshme e Republikës së Kosovës nga ana e Qeverisë bartet në shfrytëzim të komunave në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe në mungesë të paraqitjes së argumenteve dhe dëshmive përkatëse se ku qëndron konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të tij dhe Qeverisë. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, edhe pas kërkesës së Gjykatës për sqarim, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar apo elaboruar rreth asaj se si kompetencat e tij kushtetuese do të mund të cenoheshin.
76. Andaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm kërkesën e tij, sipas kriterëve të parapara me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës, nenin 31 dhe 32 të Ligjit dhe rregullin 68 të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.
77. Gjykata, megjithatë në fund thekson se, përfundimet e nxjerra më lart, nuk paragjykojnë në asnjë mënyrë nëse vendimet e Qeverisë të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, janë apo jo në përputhje me Kushtetutën apo nëse ato kanë apo jo bazë ligjore.

Përfundime

78. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës për konflikt të pretenduar në mes të kompetencave kushtetuese të tij dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës shpallet e papranueshme për shqyrtim në merita për arsyet e elaboruara në këtë Aktvendim për papranueshmëri.
79. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, ndonëse është palë e autorizuar që të ngritë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të tij dhe Qeverisë, nuk e ka dëshmuar që çështja e ngritur ndërlidhet me kompetencat e tij kushtetuese të parapara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 3 (1), të Kushtetutës, nenet 31 dhe 32 të Ligjit, dhe rregullat 59 (b) dhe 68 të Rregullores së punës, më 13 qershor 2019, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar që çështja e ngritur ndërlidhet me kompetencat e tij kushtetuese të parapara me Kushtetutë;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi